



UNMIK



IPVQ

INSTITUCIONET E PËRKOHSHME VETËQEVERISESE
 PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT
 PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLJANJA
 QEVERIA E KOSOVËS – GOVERNMENT OF KOSOVO – VLADA KOSOVA

MINISTRIA E ARSIMIT	MINISTRY OF EDUCATION	MINISTARSTVO ZA OBRAZOVANJE
SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISE	SCIENCE & TECHNOLOGY	NAUKU I TEHNOLOGIJU
Kabineti i Ministrimit	Office of the Minister	Kabinet Ministra

UDHËZIM ADMINISTRATIV

Zbatimi i kurrikulit të shkollës shqipe të mësimit plotësues në diasporë

NUMËR : 50 /2007

DATË: 13.11.2007

Në bazë të pikës (b) të nenit 6.1, të nenit 12.2 të Ligjit mbi Arsimin Fillor dhe të Mesëm si dhe në bazë të pikës (d) të nenit 1.3 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/19 mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë (IPVQ), si dhe paragrafit 7 të nenit 25 të Rregullores së Qeverisë nr. 01/2007 për punën e Qeverisë, Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë nxjerr këtë Udhëzim administrativ:

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i këtij udhëzimi administrativ është zbatimi i kurrikulit të shkollës shqipe të mësimit plotësues në diasporë si rezultat i ristrukturimit të sistemit të arsimit.

Neni 2

Kurrikuli

Kurrikuli i shkollës shqipe të mësimit plotësues në diasporë i është bashkangjitur këtij Udhëzimi administrativ.

Neni 3

Zbatueshmëria

1. Kurrikuli i shkollës shqipe të mësimit plotësues në diasporë zbatohet nga viti shkollor 2008/2009.
2. Me zbatimin e kurrikulit të shkollës shqipe të mësimit plotësues në diasporë shfuqizohen planet dhe programet e deritashme edukative-arsimore të mësimit plotësues në diasporë.

Neni 4

Hyrja në fuqi

Ky Udhëzim administrativ hyn në fuqi me nënshkrimin e tij nga Ministri.

Agim Veliu, ministër